**VENDIM**
**Nr. 207, datë 8.10.2021**

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "VOLTALIA" SA DHE OST SHA, PËR VLERËSIMIN DHE PRANIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN STANDARDE TË LIDHJES, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 87, DATË 20.4.2018**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, pika "h", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 129/5 prot., datë 6.10.2021 nga drejtoritë teknike, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Voltalia" s.a. dhe OST sh.a., "Për vlerësimin dhe pranimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen standarde të lidhjes, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018",

konstatoi se:

Shoqëria "Voltalia" s.a., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 745/6 prot., datë 11.6.2021, ka paraqitur kërkesën për vlerësimin dhe pranimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen standarde të lidhjes të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, "Mbi miratimin e rregullores së procedurave, për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, si dhe marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit".

ERE, nëpërmjet shkresës nr. 745/3 prot., datë 23.6.2021, dërguar OST sh.a., i ka kërkuar OST sh.a., të shprehë qëndrimin e saj lidhur me propozimet e kërkuara përpara shqyrtimit të kërkesës nga ana e jonë.

Shoqëritë "Voltalia" s.a., dhe OST sh.a., nëpërmjet shkresës së përbashkët të protokolluar në ERE me nr. 745/6 prot., datë 13.9.2021, kanë paraqitur marrëveshjen e lidhjes, të rakorduar nga palët, duke parashtruar, se palët kanë rënë dakord për kushtet dhe afatet e marrëveshjes së lidhjes.

Palët kanë bërë me dije se marrëveshja e propozuar ndryshon nga modeli i Marrëveshjes së Lidhjes të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, "Mbi miratimin e rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, si dhe marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit".

- Në momentin e miratimit të Marrëveshjes së lidhjes në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, nuk ka pasur asnjë impiant fotovoltaik të lidhur apo kërkesë për lidhje nga impiante të tillë, me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike. Kjo evidentohet dhe në faktin se në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, në nenin 1 "Anekset dhe përkufizimet", jepet përkufizimi i termit "impiant", si vijon: "Impiant" (në rastin e marrëveshjeve të lidhjes me impiant gjenerimi) nënkupton hidrocentralin, që do të ndërtohet nga përdoruesi".

- Impiantet gjeneruese të energjisë elektrike kanë karakteristikat e tyre, në këtë kontekst edhe impiantet fotovoltaike të gjenerimit të energjisë elektrike kanë veçoritë e tyre dhe ndryshojnë nga impiantet hidrike (hidrocentralet). Për rrjedhojë, marrja në konsideratë e këtyre karakteristikave edhe në marrëveshjet përkatëse përfshi edhe Marrëveshjen e lidhjes në rrjet është e domosdoshme. Siguria e operimit të rrjetit është një element që duhet të merret në konsideratë në planifikimin dhe

zhvillimin e rrjetit të transmetimit, në rastet e lidhjes së impianteve fotovoltaike me sisteme konvertimi, elemente që janë marrë parasysh në përpilimin e kësaj marrëveshjeje.

- Shoqëria "Voltalia" s.a. dhe OST sh.a., nëpërmjet shkresës së përbashkët të protokolluar në ERE me nr. 745 prot., datë 11.6.2021, deklaron se palët kanë rënë dakord që "Karavasta Solar" sh.p.k. do të kryejë punimet, me kostot e veta, për ndërtimin e një linje transmetimi 220 kV, përfshirë traktin përkatës 220 kV në nënstacionin Fier, për lidhjen e centralit fotovoltaik me rrjetin e transmetimit të OST-së.

- Ky përcaktim është në përputhje me "Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, në pikën 4.5.1, të kësaj rregulloreje është e sanksionuar qartë, se: "Në të gjitha rastet, kostot për lidhjen ose modifikimin e saj me rrjetin e transmetimit përballohen nga aplikuesi".

- Në të njëjtën kohë, në nenin 10, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, përcaktohet, se: "ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të këtij ligji që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre".

- Nisur nga gjithë sa parashtrohet më sipër vlerësohet se është e rëndësishme që të krijohen kushtet e nevojshme për zhvillimin dhe diversifikimin e burimeve të rinovueshme të energjisë edhe në aspektin e marrëveshjeve, që mundësojnë lidhjen me rrjetin dhe sigurinë e operimit të rrjetit dhe të impianteve gjeneruese, që reflektojnë karakteristikat dhe veçoritë e tyre, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe për burimet gjeneruese fotovoltaike.

- Neni 20, pika "h", e ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë", të ndryshuar, përcakton se: "ERE miraton kontratën tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik".

- Në këto rrethana, marrëveshja duhet të shërbejë si një marrëveshje që përcakton kushtet e përgjithshme, duke marrë në konsideratë sa parashtrohet nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me shkresën nr. 5038/1 prot., datë 12.7.2021, respektivisht:

I. Projekti të jetë zgjedhur bazuar në një proces konkurrimi.

II. Fuqia e instaluar e Impiantit të jetë nga 100 mw e lartë.

III. Çmimi i nxjerrë nga procesi konkurrues është nën 30 euro/mwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes së lidhjes me rrjetin e transmetimit ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a. dhe "Voltalia" s.a., përcjellë me shkresën me nr. 5430 prot., dt. 13.9.2021 të OST sh.a. (bashkëlidhur).

2. Marrëveshja e lidhjes shërben për projektet, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

i. janë zgjedhur bazuar në një proces konkurrimi;

ii. fuqia e instaluar është nga 100 mw e lartë;

iii. çmimi i shitblerjes së energjisë elektrike, që rezulton nga procesi konkurrues është nën 30 euro/mwh.

3. Kjo marrëveshje ndërmjet "Voltalia" s.a. dhe OST sh.a. është e vlefshme për sa kohë që respektohen kushtet e mësipërme.

4. Të ngarkohet OST sh.a., në cilësinë e të licencuarit, për të hartuar marrëveshjen e lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, për projekte të ngjashme.

5. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**